



THE FUTURE IS GREEN. LET'S "PAINT" IT TOGETHER!

 **PARTNERËT SHQIPËRI**
PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM

Gusht, 2023

PËRMBAJTJA

THE FUTURE IS GREEN. LET'S "PAINT" IT TOGETHER!	02
Qëllimi	02
Fjalë përshëndetëse	03
Sipërmarrjet pjesëmarrëse	06
Përshtypje.....	12
Impakti dhe Mbulimi Mediatik	15
JAVA E GJELBËR E BE-SË	16
EVENTET PARTNERE TË JAVËS SË GJELBËR TË BE-SË	17



THE FUTURE IS GREEN. LET'S "PAINT" IT TOGETHER!

QËLLIMI



Në vijimësi të punës dhe kontributit të Partnerëve Shqipëri prej më shumë se një dekade në mbështetje të sipërmarrjes dhe ekonomisë sociale në vend, u organizua ky event i dedikuar për të promovuar sipërmarrësit socialë dhe të gjelbër të mbështetur përmes programeve të PSH, dhe duke dhënë kështu edhe një kontribut në Agjendën Evropiane të Marrëveshjes së Gjelbër dhe Agjendën e Gjelbër dhe Digjitale për Ballkanin Perëndimor.

Më 7 qershor 2023, Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim organizuan në Kalanë e Tiranës panairin e produkteve dhe shërbimeve lokale të sipërmarrjeve sociale të gjelbërta. Panairi **"The future is green. Let's "paint" it together!"** u organizua si një Event Partner në kuadër të Javës së Gjelbër të Bashkimit Evropian (#EUGreenWeek 2023).

Sipërmarrjet sociale të gjelbërta, fituese të Konkursit të Bizneseve të Gjelbërta përgjatë viteve, si dhe sipërmarrjet sociale të mbështetura nëpërmjet iniciativave të tjera të Partnerëve Shqipëri, me produktet dhe shërbimet e tyre në sektorin e turizmit, bujqësisë, artizanatit, kulinarisë, bimëve mjekësore dhe aromatike, mirëpritën vizitorët në panair, të cilët patën mundësi të shijonin produkte dhe të njiheshin me shërbime tipike vendase, të shkëmbenin praktika, të krijonin mundësi rrjetëzimi, si dhe bashkëpunime të mëtejshme për nismat e tyre entuziaste.

**THE FUTURE IS GREEN
LET'S "PAINT" IT TOGETHER!**

*Skills for sustainable,
resilient, and socially
fair communities*

Tirana Castle
10:00 - 18:00

7
June
23

3-11 June 2023
**#EUGreenWeek
PARTNER EVENT**

PARTNERSALBANIA
FOR CHANGE AND DEVELOPMENT

FJALË PËRSHËNDETËSE

Nën sloganin "Le të mbështesim sëbashku ekonominë e gjelbër lokale!", panairi u përshëndet nga Drejtore e Partnerëve Shqipëri, Znj. Juliana Hoxha; Ministre e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, Znj. Edona Bilali, si dhe nga Kryetari i Komisionit Parlamentar për Ekonominë dhe Financat, Z. Eduard Shalsi.

Në çelje të panairit, Znj. Juliana Hoxha përgëzoi sipërmarrjet e gjelbërta për punën dhe angazhimin e tyre në aktivitete që përfshijnë jo vetëm mbrojtjen e mjedisit, kulturës, vlerave dhe traditave, por edhe zhvillimin e aftësive, duke qenë ky Viti Evropian i Aftësive 2023.



"Jam shumë e lumtur që sot të kemi midis nesh përfaqësues të sipërmarrjeve, por edhe mbështetës të rëndësishëm në nivel institucional.

Panairi është organizuar nga Partnerët Shqipëri, por puna për të mbështetur bizneset në fakt vjen si rezultat i një bashkëpunimi shumë të madh, i cili ka filluar të realizohet në mënyrë aktive në vend, qoftë në termat e bizneseve që janë mirëfilli të gjelbërta, por edhe atyre bizneseve të cilat kujdesen dhe kanë në vëmendjen e tyre promovimin e traditës, të zejeve dhe të aftësive, e që deri diku kanë filluar të humbasin me ndryshimin e brezave dhe të gjeneratave."

Juliana Hoxha,
Drejtoreshë, Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim



Ministre e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, Znj. Edona Bilali përgëzoi Partnerët Shqipëri për përzgjedhjen e bizneseve që ndikojnë jo vetëm në komunitetet e tyre të vogla lokale, por kontribuojnë në sektorë kyç të ekonomisë tonë, si turizmi, agroturizmi, bujqësia, etj.



"Fillimisht dëshiroj të përgëzoj vetë pjesëmarrësit. Është shumë kënaqësi të shohim vazhdimisht se si traditat tona risillen, por në një mënyrë më inovatore, ashtu sikurse kontribuohet me bizneset të cilat janë edhe sektorët prioritarë të shtetit tonë. Nuk mendoj që është rastësore, dhe për këtë përgëzoj edhe Partnerët Shqipëri që kanë përzgjedhur biznese që jo vetëm impaktojnë në hartat e tyre të vogla gjeografike, por që janë edhe kontributorët e shtyllave kryesore të mënyrës dhe modelit se si është e ndërtuar ekonomia shqiptare. Për bizneset kryesisht të vogla dhe të mesme, shohim që gjithmonë e më shumë ka një prirje drejt të bërit biznes në mënyrë të qëndrueshme.

Bizneset të cilat kanë një impakt mjedisor (qoftë kjo për biznese tradicionale, qoftë për startup-et), favorizohen në shumë programe qeveritare, ku ne kemi një ndër katër shtyllat prioritare pikërisht bizneset e gjelbërta dhe ato që janë pjesë e ekonomisë qarkulluese."

Edona Bilali,
Ministre e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes



Kryetari i Komisionit Parlamentar për Ekonominë dhe Financat, Z. Eduard Shalsi foli për rëndësinë e ekonomisë së gjelbër, duke e vënë theksin në komponentin social të saj dhe përgëzoi sipërmarrësit për iniciativat e tyre dhe pasionin e investuar, duke shprehur dëshirën për t'i vizituar dhe parë më nga afër secilën prej tyre.



"Në ditët e sotme po flitet gjithmonë e më shumë për ekonominë e gjelbër. Por në fakt, janë iniciativa të tilla konkrete të cilat e bëjnë më të qartë për njerëzit se përse është i rëndësishëm të qenit i gjelbër. Zhvillimi jo gjithmonë ka qenë i qëndrueshëm. Ne jemi dëshmitarë të shumë investimeve edhe në Shqipëri, ku ndonëse janë shoqëruar me leverdisshmëri ekonomike, nuk kanë qenë aq të shëndetshme dhe miqësore me mjedisin.

Pra, ekonomia e qëndrueshme, apo ekonomia e gjelbër, ka dy komponentë shumë të rëndësishëm, një nga të cilët është edhe ai që ne e shohim këtu, që është pjesëmarrja sociale. Ishte impresionuese të vizitoje për një kohë të shkurtër standat e këtyre grave dhe burrave të talentuar dhe të apasionuar, të cilët me produktet e tyre (një pjesë të të cilave i kisha dëgjuar dhe një pjesë të të cilave i njoha këtu) tregojnë më mirë se si mundet ekonomia e gjelbër të fuqizojë komponentin e përfshirjes sociale. Jam i bindur se mbas pasionit të të gjithë këtyre burrave dhe grave të talentuar, ekonomia rritet dhe ekonomia zhvillohet."

Eduard Shalsi,
Kryetar, Komisioni Parlamentar për Ekonominë dhe Financat





SIPËRMARRJET PJESËMARRËSE

Në panair morën pjesë 11 sipërmarrje sociale të gjelbërta: **Mjedrat e Danjës, Qendra për Edukim Kulinar, Reality Escapers Albania, Tradita ime Artizanale, Rinora Handmade, Qukapiku Lodra Edukative, Pemla.al, Shebenik Egnatia Explorers, Purteka-Kopshtaria për Fëmijë, Traditë Myzeqare, dhe Trendy Traditë.**

MJEDRAT E DANJËS

Ferma është ngritur në bashkinë e Vaut të Dejës, ku kultivohet fruti i mjedrës, duke sjellë kështu një produkt të ri për zonën, e duke ofruar për konsumatorin një frut organik të certifikuar sipas standardit "Organic", pajisur me vlera të larta ushqyese. Ajo synon të jetë ferma e parë që angazhohet në kultivimin e Mjadrës në territorin e Bashkisë së Vaut të Dejës dhe në qarqet e Shkodrës dhe të Lezhës.

Fituese e Konkursit Kombëtar të Bizneseve të Gjelbërta 2023.



QENDRA PËR EDUKIM KULINAR (QEK)

QEK është një organizatë jofitimprurëse e cila përveç qëllimeve të edukimit në fushën e kuzhinës, përdor edhe burime të tjera, për t'u përfshirë gjithnjë e më shumë në sisteme të qëndrueshme ushqimore dhe jetese të qëndrueshme. Nëpërmjet Tirana Green Living (TGL), misioni i së cilës është të promovojë vlerat sociale, integrimin e komunitetit dhe të mbështesë ekonominë vendase duke ofruar produkte ushqimore me cilësi të lartë dhe me kosto të ulët, QEK ka patur një ndikim të rëndësishëm në komunitetin vendas.


Fitues i Konkursit Kombëtar të Bizneseve të Gjelbërta 2019.

REALITY ESCAPERS ALBANIA

Reality Escapers Albania është një operator turistik që ofron shërbime kryesisht në sportet në natyrë, si ecje malore, kampet, vëzhgimi i shpendëve dhe turet me kajak në zonat përreth Vlorës. Reality Escapers Albania ofron si shërbim të ri turet "hiking", të cilat përfshijnë ngjitjen në majën e Çikës, gjiret fantastike dhe të egra të Gadishullit të Karaburunit, shpellat ujore; lundrimin me kajak në basenin e lumit Vjosa dhe Lagunen e Nartës në Zvërnec, si dhe vëzhgimin e shpendëve.


Fitues i Konkursit Kombëtar të Bizneseve të Gjelbërta 2023.




 [realityescapersalbania](https://www.instagram.com/realityescapersalbania)

 [realityescapersalbania](https://www.facebook.com/realityescapersalbania)



 [tradita_ime_artizanale](https://www.instagram.com/tradita_ime_artizanale)

 [traditaimeartizanale.com](https://www.traditaimeartizanale.com)

TRADITA IME ARTIZANALE

Tradita ime Artizanale është një sipërmarrje sociale e themeluar nga Fondacioni Joscelyn në vitin 2021, e cila zbaton aktivitetet e saj në një pronë të konfiskuar nga krimi i organizuar në qytetin e Elbasanit. Qëllimi i saj është të mbështesë gratë në nevojë përmes ofrimit të mundësive për trajnim dhe punësim në sipërmarrjen sociale. Artikujt e prodhuar janë qilima, rrugica, çanta, centro, etj., të cilat shoqërohen me sloganin "Duke blerë produktet e sipërmarrjes sociale, ju kontribuoni në ruajtjen e traditës, mbështesni një grua në nevojë dhe fuqizoni një fëmijë".

Mbështetur nga Partnerët Shqipëri përmes projektit TWIST.


RINORA HANDMADE

Rinora Handmade është një sipërmarrje e cila fokusohet në prodhimin e sapunëve artizanalë dhe sfungjerit bimor "Made in Albania" nga Luffa, duke i ofruar konsumatorëve një produkt natyral prodhuar nga lëndët e para të vendit tonë.

Si pjesë të përgjegjësisë sociale të biznesit, 10% e të ardhurave nga shitja e çdo produkti Rinora Handmade shkon për mbështetjen e grave dhe fëmijëve, viktimat të dhunës.


Fitues i Konkursit Kombëtar të Bizneseve të Gjelbërta 2020 dhe fitues i Konkursit Rajonal Balkan Green Ideas 2020.



 [rinorahandmade](https://www.instagram.com/rinorahandmade)

 [rinorahandmade](https://www.facebook.com/rinorahandmade)



 [qukapiku.al_lodra_druri](https://www.instagram.com/qukapiku.al_lodra_druri)

QUKAPIKU LODRA DRURI EDUKATIVE



Startup, i fokusuar në prodhimin e lodrave edukative prej druri, të prodhuara nga druri natyral, të patrajtuara me substanca kimike, të certifikuara me certifikatën FSC (nga pyje të menaxhuara në mënyrë të qëndrueshme). Është startup-i i parë në Shqipëri që vepron në këtë fushë, duke kontribuar në krijimin e një produkti me vlerë të shtuar për klientët, në mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet praktikave eko-miqësore dhe në ofrimin e mundësive të punësimit për komunitetin lokal.

Fitues i Konkursit Kombëtar të Bizneseve të Gjelbërta 2022.

PEMLA.AL

Sipërmarrja sociale prodhon gjalpë arrash në mënyrë artizanale me cilësi të lartë, duke përdorur përbërës lokalë, si dhe synon të stimulojë zhvillimin ekonomik të zonave rurale përmes promovimit të kultivimit të pemës së arrës dhe farave vajore. Liçencuar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU), produktet janë gjalpë arre, lajthie, bajameje dhe gjalpë fistikash me përbërës lokalë, të cilat janë të pranishme në supermarkete dhe dyqane ushqimesh të shëndetshme në Tiranë.

Fituese e Konkursit Kombëtar të Bizneseve të Gjelbërta 2019.



SHEBENIK EGNATIA EXPLORERS


Shebenik Egnatia Explorers është një operator turistik, shërbimet e të cilit kanë të bëjë me ngritjen e kampeve në Parkun Kombëtar të Shebenikut dhe në segmente të veçanta të rrugës Egnatia. Kampet u ofrojnë turistëve akomodim, dhe janë konceptuar si të përbëra nga një shumëllojshmëri aktivitete, duke përfshirë lojëra, vrojtimin e yjeve me teleskop, shijimin e ushqimeve tradicionale vendase dhe organizimin e tureve me biçikletë.

Fitues i Konkursit Kombëtar të Bizneseve të Gjelbërta 2022.

PURTEKA- KOPSHTARIA PËR FËMIJË

Konsiston në një dyqan “shëtites” për shitjen e produkteve si: libri “Kopshtaria për fëmijë” me autore vetë sipërmarrësen, që përmban projekte për mbjelljen e 38 bimëve në vazo e në kushte shtëpie; paketa me fara bimësh të konsumueshme, shoqëruar me një doracak dhe udhëzues për t’u përdorur nga fëmijët në kushtet e shtëpisë; si dhe objekte të tjera kopshtarie si çanta ‘tote bags’, ujitëse, hotele bletësh, ushqyese të zogjve të lirë, fidanë lulësh, perimesh e pemësh, etj. për të plotësuar kështu gamën e një dyqani.

Fitues i Konkursit Kombëtar të Bizneseve të Gjelbërta 2023.



TRENDY TRADITË

Trendy Traditë konsiston në ruajtjen e kulturës e traditës lokale përmes veshjeve tradicionale të zonës së Vaut të Dejës, dhe promovimin e punës artizanale e kalimin e saj tek brezi i ri. Synimi është ruajtja dhe avancimi i kësaj tradite, si dhe ofrimi i modeleve të reja ku ndërthuren elementët tradicionalë me ata bashkëkohorë, sipas nevojave dhe kërkesave të klientëve, duke e kthyer biznesin në një aset për zonën.


Fituese e Konkursit Kombëtar të Bizneseve të Gjelbërta 2023.

SHPORTA MYZEQARE

Sipërmarrje sociale e cila bashkëpunon me prodhuesit vendas të Myzeqesë për të prodhuar produktet që synojnë t'i japin rëndësinë e duhur punës së grave dhe burrave që i përkushtohen bujqësisë në këtë zonë. Shporta Myzeqare bën bashkë dy filozofi: "njëra sheh prejardhjen, tjetra sheh të ardhmen." Frutat dhe perimet nuk përmbajnë kimikate dhe përpunohen në temperatura të ulëta, për të ruajtur karakteristikat organoleptike dhe ushqyese. Lëngu i rrushit dhe molla përdoren për të ruajtur ëmbëlsinë dhe viskozitetin e reçelrave. Sipërmarrja është certifikuar sipas standardeve HACCP.

Mbështetur nëpërmjet projektit RISE Alb.



 Engim Albania



PËRSHTYPJE



"Pemla kishte kënaqësinë dhe privilegjin të merrte pjesë në panairin e organizuar në kuadër të "EU Green Week". Misioni i Pemplës është i lidhur ngushtë me krijimin e një të ardhmeje të gjelbër, kështu që për ne ishte një kënaqësi e veçantë të ishim ndër bizneset e gjelbërta përfaqësuese në Shqipëri dhe të ndanim këtë mision në këtë kuadër me publikun e gjerë. Gjatë këtij panairi u takuam gjithashtu me biznese të tjera me misione të ngjashme, me përfaqësues të institucioneve qeveritare që kanë si qëllim mbështetjen e bizneseve vendase, gjë që është shumë e rëndësishme për ne biznese të vogla, si dhe me përfaqësues të shoqërisë civile. Gjatë këtij panairi, patëm mundësi gjithashtu të shisnim produkte dhe të lidhim kontakte me biznese të tjera që mund të jenë të interesuara për bashkëpunim "B2B" me ne.

I jemi mirënjohës Partnerëve Shqipëri për këto mundësi të vazhdueshme që na ofron, për të bashkëpunuar dhe për të ekspozuar punën dhe arritjet tona."

Ana Shima, për "Pemla.al"

"Të marrësh pjesë në evente të cilat promovojnë përgjegjësinë sociale dhe vlerat ekologjike do të thotë që jo vetëm subjektet tashmë janë të përgjegjshme për kontributin që japin, por edhe individët e vlerësojnë atë. Këto iniciativa kanë nevojë që të organizohen më shpesh dhe të jenë të shtrira në kohë, në mënyrë që promovimi të jetë i vazhdueshëm, bazuar kjo në vlerësimet e pjesëmarrësve për produktet e ekspozuara në event."

Saimir Bakalli, për "Joscelyn Foundation"





"Gjatë panairit, pata mundësi të shkëmbeja kontaktet me disa pjesëmarrës si dhe vizitorë, turistë të interesuar për shërbimet që Reality Escapers Albania ofron. Për mua personalisht, panairi i përmbushi të gjitha pritshmëritë."

Ornold Bazaj, për "Reality Escapers Albania"

"Çfarë do të vlerësoja më shumë është fakti që gjatë panairit, kemi mundur të shesim produktet tona dhe kemi kontaktuar klientë të rinj. Besoj se organizata si kjo e jona, që shesin produkte tipike vendase, mund të përfitojnë shumë nga evente të tilla. Shpresojmë të kemi mundësi të marrim pjesë edhe në panairë të tjera."

Eleonora Drudi, Engim Internazionale, për "Shporta Myzeqare"

"Panairi ishte shumë i dobishëm për ne pasi na dha mundësinë të reklamim punën tonë. Organizimi dhe përzgjedhja e vendit, duke qenë i aksesueshëm nga turistë vendas dhe të huaj, na krijuan mundësinë që të takonim dhe vendosim kontakte me blerësit."

Avenola Liço, për "Qendra per Edukim Kulinar"





“Duke operuar në sektorin e shërbimeve, panairi shërbeu si një mundësi për të përfaqësuar biznesin tonë si dhe për të vendosur kontakte të drejtpërdrejta në ndihmesë të aktiviteteve që ne zhvillojmë. Panairi na ka motivuar dhe ka rritur dëshirën për të marrë pjesë në panairë të tjera, si një mundësi për të promovuar Shebenik Egnatia Explorers.”

Lytfi Alliu, për “Shebenik Egnatia Explorers”

“Gjatë panairit arrita të realizoj shitje, të njoh njerëz të rinj dhe bashkëpunëtorë potencialë, me të cilët shkëmbyem eksperiencë dhe ndamë informacione. Do të vlerësoja maksimalisht organizimin e panairit, përkrahjen e ofruar nga stafi i Partnerëve Shqipëri, pjesëmarrësit, si dhe komunikimin e drejtpërdrejtë me Znj. Bilali dhe Z. Shalsi. Duke qenë një biznes ende i ri, për mua kjo ka qenë një eksperiencë e re, e bukur dhe e veçantë!”

Sentiljana Marku, për “Mjedrat e Danjës”



IMPAKTI DHE MBULIMI MEDIATIK

"Panairi "The future is green. Let's "paint" it together!" u promovua nën temën gjithëpërfshirëse #EUGreenWeek në faqet zyrtare dhe profilet e mediave sociale të Partnerëve Shqipëri dhe ato të platformës Dua Partner Invest, së bashku me promovimin realizuar nga vetë sipërmarrjet pjesëmarrëse.

Panairi u promovua edhe në kanalet televizive kombëtare, duke theksuar rëndësinë e organizimit të këtij lloji event, për të mbështetur iniciativat novatore të zhvillimit të qëndrueshëm vendas në Shqipëri. Ai u transmetua drejtpërdrejt gjatë emisionit "Scan Update" në Scan TV, i ndjekur nga reportazhi i cili prezantoi sipërmarrjet sociale të gjelbërta me produktet dhe shërbimet e tyre, si dhe u pasua me daljen mediatike në emisionin "Mirëmëngjes Shqipëri" në Radio Televizionin Shqiptar (RTSH).

Ky promovim vjen si pasojë e bashkëpunimit të gjatë të Partnerëve Shqipëri me median dhe mbështetjes së ofruar për nismat sipërmarrëse ndër vite.



JAVA E GJELBËR E BE-SË

"Java e Gjelbër e BE-së" është një ngjarje vjetore e organizuar nga Drejtoria e Përgjithshme për Mjedisin e Komisionit Evropian, që shërben si një mundësi për të ndërgjegjësuar, promovuar dhe diskutuar mbi politikën mjedisore evropiane. Ajo shërben për të festuar ecurinë, si dhe për të inkurajuar individët, komunitetet dhe organizatat që të ndërmarrin veprime më aktive në të ardhmen - për të mbrojtur, ruajtur dhe rigjeneruar mjedisin, për brezat aktualë dhe ata të ardhshëm, duke promovuar vazhdimisht zhvillimin e qëndrueshëm.

Ky event i nivelit të lartë tërheq politikëbërësit, ambientalistët, aktorët kryesorë dhe palët e interesuara nga e gjithë Evropa dhe globi.

Java e Gjelbër e BE-së 2023 u zhvillua nga data 3 qershor deri më datën 11 qershor 2023, nën tematikën gjithëpërfshirëse të Marrëveshjes së Gjelbër Evropiane "Aftësi për komunitete të qëndrueshme, të forta dhe të drejta".



EVENTET PARTNERE TË JAVËS SË GJELBËR TË BE-SË

Eventet Partnere të Javës së Gjelbër të BE-së janë aktivitete të organizuara në kuadër të "Javës së Gjelbër të BE-së" nga shkollat, universitetet, shoqatat e biznesit, OJF-të, organizatat mjedisore, shoqëria civile dhe agjencitë qeveritare, grupet e qytetarëve, grupet rinore, partnerët socialë, aktorët kryesorë në sektorë të tjerë, e kështu me radhë, të cilat zhvillohen në të gjithë Evropën dhe më gjerë, me qëllim për të rritur ndërgjegjësimin dhe për të edukuar njerëzit në lidhje me rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit dhe promovimin e praktikave të qëndrueshme të jetesës.

Duke qenë në të njëjtën linjë me Vitin e Aftësive, fokusi i Eventeve Partnere për vitin 2023 ishte në temat e aftësive për komunitete të qëndrueshme, të forta dhe të drejta. Eventet u organizuan në nivel lokal, rajonal, kombëtar ose evropian dhe përfshinin një sërë aktivitete, të tilla si workshop-e edukuese, seminare, si dhe projekte miqësore me mjedisin, të cilat theksonin rëndësinë e aftësive "të gjelbra" - aftësi që do t'i fuqizojnë njerëzit të bashkohen dhe të kontribuojnë drejt tranzicionit të gjelbër.

Secili aktivitet u realizua në përputhje me tre synimet e ndërlidhura tematike të politikës mjedisore të Komisionit Evropian, të cilat u trajtuan gjatë javës së gjelbër të BE-së: Zero Ndotje, Ekonomia Qarkulluese, si dhe Biodiversiteti.



synimi tematik
"Zero Ndotje"



synimi tematik
"Ekonomia Qarkulluese"




synimi tematik
"Biodiversiteti"

Në total, këtë vit u organizuan rreth 261 evente partnere, të shpërndara në 36 vende të ndryshme.


Tipet kryesore të aktiviteteve u organizuan sipas 8 kategorive kryesore: Trajnime dhe workshop-e; konferenca dhe samite; seanca informuese; debate publike; ekspozita; takime me ekspertë; fushata; si dhe konkurse dhe ceremoni për ndarje çmimesh.

Numri i eventeve të organizuara sipas secilës kategori është paraqitur në Grafikon 1.



Grafik 1. Numri i eventeve partnere të organizuara sipas secilës kategori

Secili aktivitet mbuloi më shumë se një tematikë të vetme, ku pjesa më e madhe e tyre kontribuan në tematikën "Ekonomia e Gjelbër", të ndjekur nga ato aktivitete që kontribuan në tematikën "Zgjidhjet e bazuara në natyrë", "Kompetencat kryesore", e kështu me radhë. Tematikat e mbuluara nga aktivitetet partnere të organizuara janë paraqitur në Grafikon 2.



Grafik 2. Numri i eventeve partnere të organizuara sipas secilës tematikë të mbuluar



Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim

www.partnersalbania.org

Rruga e Elbasanit, Park Gate Building,
kati i 10-të, Ap. 71 / 73,
Tiranë, Shqipëri